



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 1

Prishtinë, më 6.02.2008, ora 10:00

**Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës,
salla N-10**

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Hajdin Abazi, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxherri, Müfera Şinik.

Anëtarët jo të pranishëm: Behxhet Pacolli, Driton Tali.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Zyrtare e lartë ligjore, Arta Hajra, Zyrtare ligjore, Vilson Ukaj, Zyrtar ligjor.

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitruues nga OSCE, KDI.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i komisionit

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Mbledhja konstituive e Komisionit.**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari hapi mbledhjen konstituive të komisionit në legjislaturen e re të III-të, përshëndeti të pranishmit dhe uroj për përzgjedhjen si deputet të Kuvendit si dhe anëtarë të këtij komisioni. Ai kërkoi nga ata nëse pajtohen me rendin e ditës apo bashkarisht mund të fusim edhe pika tjera në këtë rend dite.

Pasi nuk pati kërkesa tjera kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar.

2. Mbledhja konstituive e Komisionit

Kryetari thëksoi se komisioni ka bazën e vet kushtetuese dhe është ndër dy komisionet kryesore dhe si rezultat i kësaj na pret një punë e madhe por besoj se bashkarisht do t'ia dalim. Një pjesë e anëtarëve e dinë rolin, rëndësinë dhe përbërjen e këtij komisioni, pasi që kanë qenë anëtarë të të njëjtit komision në legjislaturat e kaluara, por besojë se edhe anëtarë e rinj kanë informacionet e përgjithshme për punën e tij dhe ne do të jemi bashkëveprues në kryerjen e detyrave të përbashkëta që ka ky komision. Përgjegjësitë e këtij komisioni janë përcaktuar me Kornizën Kushtetuese e që janë specifikuar edhe me Rregullorën e Punës së Kuvendit dhe do të dëshiroja të i keni parasysh ato.

Si udhëheqës do të përpiqem maksimalisht të jem bashkëpunues dhe bashkëveprues, të pajtohem apo do të kundërshtohem aty ku duhet në interes të përgjegjësive dhe detyrave që i kemi, nuk do të dëshiroja që ky komision të ndahet në pozitë edhe opozitë por të jetë komision që do të punon në të mirë të punës së Kuvendit.

Në vazhdim kryetari kërkoi nga anëtarët që ta marin fjalën lidhur me rendin e ditës si dhe të zhvillojnë një bashkëbisedim edhe për çështjet tjera që kanë të bëjnë me punën e këtij komisioni gjatë këtij mandati.

Besa Gaxherri përshëndeti të gjithë të pranishmit. Ajo u pajtua me kryetarin e se ky është ndër dy komisionet kryesore i cili ka specifikën e vet në trajtimin e implikimeve buxhetore të projektligjeve që do t'i shqyrtojmë dhe puna e tij është një çështje e ndjeshme. Në dy mandatet e kaluara kam bashkëpunuar me kryetarin dhe me deputetën znj.Safete Hadërgjonaj si dhe me ish ministrin e MEF z.Haki Shatrin i cili edhe ka qenë kryesues i komisionit në legjislaturën e parë dhe tanimë kemi krijuar një përvojë rreth mënyrës dhe metodat e punës.

Znj.Gaxherri tha se do të jem konstruktive nëse ju si pozitë do ta luani rolin e bashkëpunimit për funksionimin e mirë të këtij komisioni aq të djeshëm për punë e tij dhe të Kuvendit. Duke ditur e që tërë problematika lidhet me problemin e buxhetit të Kosovës bashkëpunimi është i domosdoshëm për të bërë ndryshime. Përderisa unë si opozitë jam e gatshme besojë se edhe ju si pozitë do të pajtoheni me mendimin tim.

Haki Shatri vlerësoi rëndësinë e këtij komisioni e që për shumicën e anëtarëve tashmë është e njohur por besojë se edhe anëtarët e rinjë kanë marrë informacione se vendimet e këtij komisioni janë obligative për Kuvendin. Ajo që është e rëndësishme për ne është se që në ditën e parë të vendosim të prezentojmë format e rregullave të punës së komisionit të cilat janë forma që vlejné edhe për format e vendimarrjes në Kuvend.

Ndërsa si çështje të dytë garantoj se nuk do të jetë as në anën e pozitës e as opozitës por do të mbështes atë që i ofron argumente për një vendim apo rekomandim më të mirë.

Kjo duhet të vlejë për vendimet që i merr komisioni për buxhetin e konsoliduar apo edhe vendimet për implikimet buxhetore që mund të ketë një projektligj.

Mendoj se duhet bërë të qartë Kuvendit se vendimet e këtij komisioni janë obligative për Kuvendin. Nëse ky komision nuk jep notën pozitive të një dokumenti, ai nuk mund të futet në rend dite për shqyrtim në seancë plenare. Kjo kërkon diskutimin e çështjeve në mënyrë profesionale pa dallime pozitë-opozitë.

Prandaj duke pasur parasysh rëndësinë e këtij komisioni z. Shatri propozojë që t'i bëhet një kërkesë USAID-it për të mbështetur komisionin me një këshilltar profesionist që do të këshillonte anëtarët për ligjet, vendimet dhe zgjidhjet sistemore. Shprehu besimin se ata janë të gatshëm të na ofrojnë përkrahje sidomos për gjërat specifike.

Safete Hadërgjonaj përshëndeti kryetarin duke shprehur besimin se do ta luan rolin e vet që të jemi unifikues dhe puntorë të mirë gjatë këtij mandatin në këtë komision. Ky komisioni ka rëndësinë e veçantë për faktin se është ndër dy komisionet kryesore, prandaj besoj se edhe anëtarët e rijnë e kanë lexuar Rregullorë e Punës së Kuvendit dhe tashmë e dinë rolin dhe rëndësinë e tij.

Ajo shprehu mendimin e egzistimi të opozitës e cila me kritikën e veta do të mund të i ndihmojë edhe pozitës në trajtimin e atyre çështjeve që janë të neglizhuara shpeshherë dhe të rëndësishme për komisionin. Të angazhohemi bashkarisht që të kemi rezultate si përfundim. Në vazhdim vëmendjen e përqëndroi në miratimin e buxhetit 2008 si një punë të ngutshme i cili ende nuk është miratuar. Shprehu besimin se në të ardhmen do të bëjmë më shumë duke ditur faktin se ligji mbi buxhetin është ligji kryesorë që miratohet në Kuvend dhe puna kryesore e punës së Kuvendit.

Znj.Hadërgjonaj tha se planin tre mujor do duhej ta diskutojmë dhe miratojmë në mbledhjen e ardhshme dhe mandej do të vazhdojmë punën. Kryesisht janë punë që kanë mbetur pu u përfunduar nga komisioni i legjislaturës së kaluar me disa punë të reja që do të lindin më vonë.

Myrvete Pantina përshëndeti të gjithë të pranishmit. Shprehu mendimin e saj për rolin dhe rëndësinë që ka ky komision i cili ka të bëjë me menaxhimin e mjeteve të buxhetit të konsoliduar e që janë mjete të qytetarëve të Kosovës, prandaj roli ynë duhet të jetë në menaxhimin dhe analizimin sa më të mirë të këtyre mjeteve dhe në orientimin e tyre në prioritetet më të mëdha. Përgjegjësia jonë është ndaj qytetarëve andaj të angazhohemi në pengimin e parregullësive dhe keqpërdorimeve të tyre duke kërkuar arsyetimet nga institucionet përkatëse që bëjnë shpenzimin e këtyre mjeteve.

Armend Zemaj falenderoj kryetarin dhe përshëndeti të pranishmit. Tha se është nderë që është deputet i kësaj legjislature dhe si antarë i komisionit njëkohësisht. Vlerësoi përparësi pranin e ish ministrit në komision i cili besoj se kontributi i tij do të jetë maksimal dhe profesional. Në bazë të raportit mandator ai ka vërejtur një dinamikë të ngadalshme të punëve dhe shprehu bindjen se tani do të kemi një qasje më konkrete dhe një dinamizëm më të madhë në punë. Kërkoj që të këtë në mbledhjen e ardhshme një bashkëbisedim më të gjërë rreth planit të punës dhe në të të përfshihen në mënyrë më të detajuar punë që do duhej te i kryejmë gjatë kësaj kohe.

Xhevdet Neziraj falenderoj kryetarin dhe urojë atë për punë të mbarë në udhëheqjen e komisionit Ai tha se edhe pse nuk ka qenë pjesë e këtij komisioni ka përvojën e tij si deputet dhe premtojë se do të zhveshet nga spektri i tij politik dhe etnik në mënyrë që të kontribuojë në të mirën e këtij komisioni si e mirë e gjithëve. Përkrahu kritikën si mendim pozitiv dhe profesional e cila do të mund t'i ndihmonte edhe menaxhimit sa më të mirë të mjeteve buxhetore, të cilën gjë e ka bërë edhe kur kam qenë pjesë e qeverisë së kaluar.

Hajdin Abazi përshëndeti të gjithë të pranishmit. Theksoi që nuk ka punuar në komisionet parlamentare por ka përvojën në çështjet që janë të ngjajshme me punët që i kryen komisioni. Shpreu gatishmërinë e tij që të jetë efikas në mënyrë që puna e komisionit të mos paraqet pengesë për punën e mëtutjeshme në Kuvend në procedimin e projektligjeve . Vlerësoi lehtësi praninë e ish ministrit që me përvojën e tij do të na ndihmojë që realisht të ndryshojmë ato që duhet ndryshuar. Përkrahu mendimin kritik pozitiv por nuk dëshiron që të shëndrrohemi në krticist ku edhe për gjërat më teknike e që do ta vështirësonim punën e komisionit. Personalisht garantoj se do të përkrahu ato vendime që sjellin fakte dhe argumente të cilat ndihmojnë në korrektimin e punës së qeverisë dhe të metave të saja që mund t'i bëjë. Prandaj kërkoj që të konfrontohen faktet e jo ne si individ apo personalitete. Kjo çasje do ta bënte më efikase punë tonë dhe do të ishte mirë që të angazhohemi në këtë drejtim.

Kosara Nikolić përshëndeti të pranishmit dhe u prezantua si deputete e re në Kuvendin e Kosovës. Është në pension dhe tanimë ka një përvojë të mirë që do të orientohet në përpjekjet e saja për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallime. Shprehu besimin se bashkarisht do të kryejm detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi. Përkrahu mendimin e kolegëve për kritikën dhe mendimin pozitiv që do të ndihëmonte në punën konstruktive të komisionit. Ofroj gatishmërin e saj se do të jetë konstruktive në këtë drejtim.

Müfera Şinik përshëndeti të gjithë, veçanarisht kryetarin. Tha se ndihet krenare që është pjesë e këtij komisioni aq të rëndësishëm. Shprehu besimin se deputete e re do ta ketë mbështetjen e kolegëve të mëhershëm që të jetë më e sukseshme.

Kryetari parshtrij tri çështje që duhet të merren në vazhdim:

- Çështje e parë ka të bëjë me miratimin e buxhetit të konsoliduar 2008 që duhet bërë me një procedurë më të përshpejtuar për arsye se nuk kemi pasur mundësi që në afain e paraparë ta shqyrtojm buxhetin e qeverisë së kaluar andaj duhet që puna rreth miratimit të buxhetit të përfundoj gjatë këtij muaji.
- Çështja e dytë ka të bëjë problemin që ka paraqitur financimi i agjencioneve të pavarura. U zotua se duhet të rregullohet problemi i tyre ashtu siç është përcaktuar me ligj në drejtim të menaxhimit dhe finacimit të drejtë të tyre. Nëse ligjet nuk janë adekuate të kërkojmë ndryshimin e tyre. Përmendi dy agjesione ART-në dhe ZRRE të cilat krijojn të hyra dhe duhet rregullohet në mënyrë precizuar ligjore funksioni i tyre, por edhe i agjencioneve tjera.
- Çështja e tretë ka të bëjë me ligjet dhe vendimet lidhur implikimet buxhetore të cilat nuk mund të shqyrtohen në Kuvend pa kaluar në komision. Në këtë drejtim pati vërejte drejtuar Kryesisë së Kuvendit e cila deri më tani disa herë nuk ka

përfillur rekomandimet dhe vendimet e komisionit dhe ka nxjerrur një vendim tjetër që është në kundërshtim edhe me Rregullorën e Punës së Kuvendit.

Vendimet e këtij komisioni mund të i miratojë ose hedh poshtë vetëm Kuvendi. Kërko që të ndryshohet roli i komisionit edhe në këtë drejtim.

Safete Hadërgjonaj edhe pse prioritet në këtë kohë të shkurtër është buxheti kërkoj që të rregullohet edhe problemi i agjencioneve buxhetore duke shprehur kritika edhe ndaj ligjeve egzistuese të cilat shpeshherë kanë ra në kundërshtim me njëra tjetrën. Lidhur me kërkesën e nënkryetarit për angazhimin e një eksperti nga USADI, në vend të kësaj ajo propozoj që të angazhohet një ekspert i përhershëm që do të punonte enkas për komisionin.

Kryetari kujtoj se komisioni ka marrë një vendim lidhur me krijimi e një zyre ekspertësh të përhershëm që do ta mbështetnin Kuvendin dhe Komisionin në veçanti por është refuzuar nga Kryesia me arsyetimin e mungesës së mjeteve.

Falenderoj organizatat që kanë mbështetur deri më tani komisionin, sidomos USADI-në, UNDP-në, OSCE-në dhe shprehu gatishtërinë për bashkpunim të cilën përkrahje tha që e ka marrë edhe prej tyre. Me këtë rast falenderoj ekspertin e UNDP-së që ka bërë rekomandimet e tij lidhur me buxhetin e dhjetorit të pamiratur si dhe rekomandimet e tij lidhur me kërkesat e organizatave buxhetore për mjete shtesë.

Lidhur me këtë tha se do të parashtrojë Kryesisë një kërkesë që të na gjëjë një këshilltar sidomos në fushën e buxhetit.

Haki Shatri këkoj që primare le të jetë aprovimi i buxhetit. Po ashtu kërkoj që buxhetet e agjencioneve buxhetore të përgatiten dhe miratohen paralelisht me buxhetin e konsoliduar edhe pse janë të ndaras prej tij.

3. Të ndryshme

Anëtarët diskutuan rreth terminit të mbajtjes së mbledhjeve. Pati propozime të ndryshme, por kjo çështje u la të vendoset në mbledhjen e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në ora 11:05
Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit
Gani Koci

